




Republika e Kosovës
Republika Kosov
Republik of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVNA
KOMUNA E VITISË - OPĆINA VITINA

Pranuar - Primljeno më Dëshira	03.06.2015		
Nr.i ordinatit	Numri	Shtojeç	Vlera
Org.broj	01-013/780	Prirod	Vrednost



Komuna Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

RR E G U LL O R E

PËR PËRGJEGJËSITË DISPLINORE DHE MATERIALE TË PUNËTORËVE ARSIMOR NË KOMUNËN E VITISË

MAJ 2014
VITI

Bazuar në nenin 12.2, shkronja **c**, nenit 40.2, shkronja **a** të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenin 5, shkronja **i** të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, në zbatim të neneve 85, 86 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, në zbatim të nenit 20, pika 2.2 të Ligjit për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 dhe në nenin 36.2, shkronja **c** e Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 27.05.2014 aprovoi këtë:

RR E G U LL O R E **PËR PËRGJEGJËSITË DISIPLINORE DHE MATERIALE TË** **PUNËTORËVE ARSIMOR NË KOMUNËN E VITISË**

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet klasifikimi i shkeljeve të detyrave të punës, procedura disiplinore, komisioni disiplinor, shqiptimi i masave disiplinore dhe përgjegjësia materiale e punëtorëve në arsim.

Neni 2

Çdo punëtor arsimor është i obliguar të përmbush detyrat e punës, në pajtim me vendimet, udhëzimet lidhur me punën të nxjerra nga Ministria e Arsimit, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe drejtoritë e shkollave në pajtim me ligjet në fuqi dhe aktet tjera.

Neni 3

Për çdo dëm material (pasuri e shkollës) të shkaktuar me qëllim apo nga pakujdesia e rëndë në punë, punëtorët arsimor përgjigjen materialisht.

Neni 4

Dispozitat e kësaj rregullore mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale janë të zbatueshme ndaj punëtorëve të arsimit, që marrëdhënia e punës i rregullohet me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.

II. Përgjegjësia Disiplinore

Neni 5

Punëtori përgjigjet për cenimin e disiplinës (detyrave të punës) në punë, të cilën e kryen me paramendim dhe nga pakujdesia e rëndë.

Neni 6

Punëtori nuk mban përgjegjësi disiplinore për veprimet/lëshimet, gjegjësisht shkeljet e detyrave të punës, të cilat me këtë rregullore ose me ligjet, aktet në fuqi nuk janë të përcaktuara si shkelje.

Neni 7

Përgjegjësia për vepër penale, delikt ekonomik ose kundërvajtje nuk përjashton përgjegjësinë disiplinore për veprën e njëjtë, nëse e njëjtë vepër është kryer në punë, apo lidhur me punën, dhe nëse me këtë Rregullore apo Ligj është paraparë si shkelje e disiplinës në punë.

Neni 8

1. Shkelja e detyrave të punës ndahen si:
 - 1.1. Shkelje të lehta të detyrave të punës;
 - 1.2. shkelje të rënda - serioze.

Neni 9

1. Shkeljet e lehta të detyrave të punës konsiderohen:
 - 1.1. Vonesa dhe dalja e parakohshme nga puna;
 - 1.2. Mungesa e paarsyetur nga puna deri në dy ditë;
 - 1.3. Dështimet e pajustifikuar për ti mbajtur mësimet e caktuara dhe forma tjera të punës edukative;
 - 1.4. Mbajtja e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike në mënyrë jo të rregullt;
 - 1.5. Shfrytëzimi jo efektiv i orës së mësimit;
 - 1.6. Mospjese-marrja në mbledhjet e Këshillit të Arsimtarëve;
 - 1.7. Përdorimi telefonit celularë gjatë orës së mësimit;
 - 1.8. Moszbatimi i udhëzimit që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të programit mësimor;
 - 1.9. Sjellja jo korrekte me nxënës, prind, mësimdhënës, bashkëpunëtor, palë dhe pengesa në punë ndaj të tjerëve;
 - 1.10. Kryerja e punëve private gjatë orarit të punës;
 - 1.11. Refuzimi i bashkëpunimit me mësimdhënësit, punëtoret tjerë, mosbartja e përvojës te punëtoret e rinj dhe praktikantet;
 - 1.12. Moslajmërimi me kohë i prishjeve të aparaturave, instalimeve si dhe mjeteve mësimore;
 - 1.13. Mosnjoftimi lidhur me sigurinë dhe shëndetin e nxënësve;
 - 1.14. Fshehja e dëmit material;
 - 1.15. Shkaktimi i dëmit në vëllim të vogël;
 - 1.16. Mospërfillja e etikës dhe pedanteria në punë, veshmbathje dhe uniformës në punë.

Neni 10

1. Shkeljet e rënda të detyrave të punës konsiderohen:
 - 1.1. Mungesa të paarsyeshme nga punë më shume se tre ditë radhazi pa lajmëruar mungesën;
 - 1.2. Kundërshtimi i paarsyeshëm për kryerjen e detyrave të punës të përcaktuar me kontratën punës dhe udhëzimet e MASHT-it;
 - 1.3. Kryerja e pandërgjegjshme, jo me kohë dhe e pakujdeshme e detyrave të punës;
 - 1.4. Lëshimi i veprimit me të cilin pengohet ose parandalohet procesi i punës dhe menaxhimi i shkollës;
 - 1.5. Moskryerja me qellim ose nga pakujdesia e detyrave të punës;
 - 1.6. Moskryerja nga pakujdesia serioze, neglizhenca në punë që shkakton humbje, lëndime dhe dëme;
 - 1.7. Refuzimi i kryerjes së punës apo urdhëresave për punë të dhëna nga drejtori i shkollës;
 - 1.8. Përsëritja sistematike e gabimeve me dashje apo pakujdesia;

- 1.9. Vjedhja, mashtrim, falsifikimi i dokumenteve zyrtare dhe dokumentacioni shkollar;
- 1.10. Dëmtimi i dokumentacionit shkollarë apo asgjësimi i tij;
- 1.11. Ndryshimi i procesverbaleve të paautorizuara në dokumentacionin shkollarë, si fshirja, shtimi i të dhënave tjera, ose lënia jashtë të dhënave;
- 1.12. Fjalosja, fyerja, nënçmimet ndaj personelit, nxënësve, dhe personave tjerë në mënyrë të vazhdueshme;
- 1.13. Përdorimi i dhunës fizike dhe psikike ndaj nxënësve;
- 1.14. Provokimet, kërcënimet, nxitura e rrëmujës përrahje gjatë punës;
- 1.15. Sjellja e keqe jashtë vendit të punës që nuk përkon me statusin punëtorit arsimor apo personelit tjetër;
- 1.16. Përdorimi i alkoolit ose drogës gjatë orarit të punës dhe sjellja e vetës në pozitë të paaftësisë përi kontrolluar sjelljet;
- 1.17. Diskriminimi i rëndë ndaj nxënësve, punëtorëve në përgjithësi, palëve, apo ndonjë personi tjetër në shkollë në bazë gjinisë, racës, ngjyresë, gjuhës, religionit, mendimeve politike, origjinës sociale, rasteve tjera të sankzionuar me ligj;
- 1.18. Ngacmimi seksual i nxënësve, punëtorëve, palëve, ose personave tjerë, i karakterizuar me sjellje fizike ose verbale të natyrës seksuale;
- 1.19. Predikim i propagandës partiake, politike tek nxënësit;
- 1.20. Inkurajimi i nxënësve që të marrin pjesë në aktivitet politike, dhe ndërprerja orës mësimore përi këto qëllime;
- 1.21. Mos ruajtja e sekretit në punë;
- 1.22. Mosmarrja e masave, mos njoftimi, apo tolerimi për dukurit negative në shkollë, si: përdorimi i substancave narkotike, duhanit, armëve, mjeteve të imprehta nga ana nxënësve;
- 1.23. Mbajtja e armëve dhe mjeteve të ndaluara brenda shkollës;
- 1.24. Keqpërdorimi i fondeve të dedikuar për aktivitet e lira të punëtoreve, nxënëseve, objektet shkollore, pajisjet ose mjetet e shkollës;
- 1.25. Keqpërdorimi i shfrytëzimit të drejtës së pushimit mjekësor;
- 1.26. Keqpërdorimi, mbledhja e të hollave nxënësve pa autorizimin e drejtorisë së shkollës;
- 1.27. Keqpërdorim i detyrave zyrtare, tejkalim i autorizimeve të detyrës së mësimdhënësit;
- 1.28. Refuzimi i konsultimit me prind apo injorimi i tyre;
- 1.29. Kundërshtimi i qasjes se prindërit apo kujdestarit te klasës në rezultatin e testeve me shkrim përi vlerësimin e nxënësve;
- 1.30. Refuzimi i pranimit të provave apo paraqitjes së provave apo moslajmërimin e shkeljes së disiplinës në punë nga ana personit arsimor apo personit që ka mbikëqyre punën e institucionit arsimor apo shkollore;
- 1.31. Dëmtimi i inventarit dhe mjeteve të konkretizimit të shkollës me paramendim apo pakujdesia serioze;
- 1.32. Vjedhja e pasurisë së shkollës.

III. Shqiptimi i Masave Disiplinore

Neni 11

1. Për shkeljen e disiplinës në punë mundë të shqiptohet njëra nga masat disiplinore në vijim:
 - 1.1. vërejtja me gojë;
 - 1.2. vërejtje me shkrim;
 - 1.3. ndalesë e pagës (mëditjes);
 - 1.4. suspendimi i përkohshëm;

1.5. ndërprerje e marrëdhënies së punës.

Neni 12

Masa disiplinore e vërejtjes me gojë, vërejtje me shkrim u shqiptohet për shkeljet e lehta të detyrave të punës, të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregullore, në pajtim me Kontratën Kolektive dhe me Kontratën e Punës.

Neni 13

Masa disiplinore, ndalese e pagës (mëditjes) shqiptohet për shkelje të lehta te detyrave të punës që shqiptohen nga drejtori i shkollës.

Neni 14

Masa e disiplinore, suspendim i përkohshëm dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës shqiptohet për shkeljet e rënda të detyrave të punës, të cilat janë të përcaktuara në nenin 10 të kësaj rregullore në pajtim me Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Marrëdhënies së Punës.

Neni 15

1. Gjatë shqiptimi të masave disiplinore të shkeljes së detyrave të punës merren parasysh posaçërisht:
 - 1.1. pesha e shkeljes së detyrave të punës dhe pasoja e saj;
 - 1.2. kushtet në të cilat është kryer shkelja e detyrave të punës;
 - 1.3. sjelljet e mëparshme të punëtorit në vendin e punës;
 - 1.4. rrethanat tjera të cilat mundë të janë me ndikim gjatë shqiptimit, ekzekutimit dhe lartësisë së masës disiplinore.

IV. Procedura Disiplinore

Neni 16

1. Me procedurën disiplinore dhe shqiptimin masave disiplinore udhëheq Komisioni Disiplinor.
2. Komisioni Disiplinor përbëhet nga kryetari i komisionit dhe dy anëtar tjerë, të cilët emërohen në kohë zgjatje prej 2 vite nga drejtori i Drejtorisë se Arsimit.
3. Njëri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të jetë me përgatitje profesionale juridike, dhe një anëtar komisionit të jetë i gjinisë femërore.
4. Komisioni i ankesave caktohet-emërohet nga drejtori i Arsimit me përbërje, me numër dhe mandat të njëjtë sikurse komisioni ankesave.

Neni 17

Procedura disiplinore iniciohet nga Drejtoria e Arsimit pas (fletëparaqitjes) njoftimit për shkelje të detyrave të punës nga ana e mësimdhënësit. Njoftimi bëhet nga drejtoria e shkollës, personeli arsimor, edhe nga pjesëtaret e publikut (prindërit), që kanë hasur në shkelje.

Neni 18

Pas njoftimit për shkeljen, Drejtoria e Arsimit në afat prej tri ditëve duhet ta intervistoj shkelësin e supozuar apo çdo person tjetër që mund ti ofroj dëshmi me rastin.

Neni 19

Pas interviewimit dhe mbledhjes se provave, nëse ekziston dyshimi i bazuar, DKA-ja është obliguar që në afat prej 2 ditëve të inicioj procedurën disiplinore pranë komisionit disiplinor për shqyrtim dhe vendosje.

Neni 20

1. Drejtoria e Arsimit, gjegjësisht sekretari juridik, pas paraqitjes se rastit në Komisionin Disiplinor e njofton me shkrim brenda tri ditëve shkelësin e supozuar për natyrën e shkeljes, kohën dhe vendin shkeljes se supozuar, që rasti ka kaluar në komisioni disiplinor, për kohën, vendin se ku do të mbahet seanca.
2. Mbi datën e shqyrtimit kryesor lajmërohet sindikata e arsimit.

Neni 21

Në çdo fazë të procedurës punëtori kundër të cilit është iniciuar procedura disiplinore mund të shoqërohet nga një anëtar i kryesisë së sindikatës.

Neni 22

1. Procedura pranë komisionit disiplinor është gojore dhe publike. Përjashtim kur imponohen arsyet tjera, publiku mund të përjashtohet në fazë të caktuara të procedurës apo gjatë tërë procedurës.
2. Komisioni disiplinor merr në pyetje punëtorin (ndaj të cilët është iniciuar procedura disiplinore), dëshmitarët si dhe persona tjerë të cilët mund të kontribuojnë në verifikimin e përgjegjësisë së punëtorit (ekspertët dhe punëtoret tjerë).

Neni 23

1. Në fillimin e shqyrtimit kryesor, kryetari i Komisionit Disiplinor verifikon a janë prezent të gjithë personat e ftuar.
2. Në qoftë se punëtori nuk është prezent, dhe nuk ekziston dëshmia se ftesa është dorëzuar, respektivisht është i penguar me arsyen që të vij, shqyrtimi do të shtyhet për një datë tjetër.
3. Në qoftë se punëtori (shkelësi i detyrave të punës) është ftuar me rregull, por mosardhjen nuk e ka arsyetur, shqyrtimi mund të mbahet dhe pa prezencën e tij.

Neni 24

1. Shqyrtimi pranë komisionit disiplinor fillon me leximin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, pas leximit të kërkesës punëtori (shkelësi i detyrave të punës) të deklarohet mbi shkeljen e disiplinës në punë e cila i ngarkohet.
2. Dëshmitarët nuk duhet të janë prezent në shqyrtimin kryesor derisa punëtori (shkelësi i detyrave të punës) jep deklaratën.
3. Dëshmitarët japid deklaratën pas punëtorit të (shkelësit të detyrave të punës).
4. Nëse në procedurë është e nevojshme mund të bëhet ballafaqimi ndërmjet punëtorit dhe dëshmitarit.
5. Pas dëshmitarëve dëgjohen ekspertët nëse janë ftuar dhe lexohen shkresat, dokumentet dhe deklaratat e dëshmitarëve të cilët nuk janë prezent në shqyrtimin kryesor.
6. Në fund të shqyrtimit kryesor ftohet punëtori (shkelësi i supozuar i detyrave të punës) që të deklaroj fjalën (mbrojtjen) përfundimtare.

Neni 25

Me shqyrtimin kryesore udhëheqë kryetari i Komisionit Disiplinor, i cili i jep dhe merr fjalën pjesëmarrësve në shqyrtim, bënë pyetje dhe kërkon sqarime nga ta. Pas kryetarit të komisionit pyetje mund të bëjnë dhe anëtarët tjerë e komisionit disiplinor.

Neni 26

1. Në procedurën para Komisionit disiplinor mbahet procesverbal, i cili përmban emërtimin e komisionit disiplinor para të cilët udhëhiqet procedura:
 - 1.1. emrin dhe mbiemrin e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit disiplinor dhe procesmbajtësit;
 - 1.2. emrin dhe mbiemrin e punëtorit kundër të cilët zhvillohet procedura disiplinore;
 - 1.3. emrin dhe dita, vendi dhe ora e fillimit dhe e mbarimit të shqyrtimit;
 - 1.4. me kërkesën e kujt është ngritur procedura dhe për të cilën shkelje të obligimeve të punës;
 - 1.5. kualifikimin e kryerjes së shkeljeve të obligimeve të punës;
 - 1.6. deklaratën e punëtorit kundër të cilët zhvillohet procedura disiplinore;
 - 1.7. deklaratën e dëshmitarëve dhe ekspertit dhe dëshmitë tjetra të prezantuara gjatë procedurës, aktvendimet e marra me qellim të udhëheqjes së procedurës etj.
2. Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari i Komisionit Disiplinor dhe pjesëmarrësit tjerë në shqyrtim.

Neni 27

Pas deklarimit të mbrojtjes përfundimtare nga ana punëtorit (shkelësit të supozuar), kryetari i komisionit disiplinor deklaron se shqyrtimi kryesor ka përfunduar.

Neni 28

1. Nëse është e nevojshme, shqyrtimi kryesore mund të ndërpritet dhe të vazhdohet një ditë tjeter.
2. Në rast të ndërprerjes së shqyrtimit kryesor dhe vazhdimit të tij në një ditë tjeter komisioni disiplinor punon në përbërjen e njëjtë.
3. Nëse komisioni disiplinor vazhdon punën e tij me përbërje të ndërruar, shqyrtimi kryesor fillon nga fillimi, me ç'rast deklaratat e dëshmitarëve dhe eksperteve do të lexohen sërisht.

Neni 29

1. Pas përmbylljes së shqyrtimit kryesor, komisioni disiplinor vendos mbi përgjegjësinë e punëtorit ndaj të cilët është iniciuar procedura disiplinore.:
 - 1.1. punëtorin ta liroj nga përgjegjësia;
 - 1.2. pezulloj procedurën disiplinore;
 - 1.3. punëtorin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoj masën disiplinore.
2. Komisioni disiplinor mundë të vendos:
 - 1.1. punëtorin ta liroj nga përgjegjësia;
 - 1.2. pezulloj procedurën disiplinore;
 - 1.3. punëtorin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoj masën disiplinore.
3. Vendimin e tij komisionit disiplinor e bien me shumicë votash.

Neni 30

1. Komisioni disiplinor bien vendim mbi lirimin e punëtorit nga përgjegjësia në rast se:
 - 1.1. shkelja për të cilën është iniciuar procedura disiplinore nuk paraqet shkelje të disiplinës së punës të përcaktuar me këtë rregulllore apo ligj;
 - 1.2. nëse nuk është e argumentuar që punëtori ka kryer shkeljen e disiplinës në punë;

- 1.3. nëse vërteton se punëtori nuk ka kryer shkelje të disiplinës në punë;
- 1.4. nëse ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë e punëtorit.
2. Përveç rrethanave të theksuara më lartë, komisioni disiplinor bien vendim mbi lirimin e punëtorit nga përgjegjësia edhe në rast se:
 - 2.1. shkeljen e disiplinës së punës nuk e ka kryer me fajin e tij;
 - 2.2. shkeljen e disiplinës së punës nuk e ka kryer në punë apo lidhur me punën;
 - 2.3. shkeljen e disiplinës së punës e ka kryer në gjendje të pallogaritshme (gjendje të përjashtuar nga përgjegjësia).

Neni 31

1. Komisioni Disiplinor bien vendim mbi pezullimin e procedurës disiplinore, nëse ka konstatuar vjetërsimin e inicimit apo vazhdimit të procedurës.
2. Komisioni disiplinor bien vendim mbi pezullimin e procedurës disiplinore për shkak të vjetërsimit, pavarësisht nga ajo se a është tërhequr vërejta nga punëtori, se shkelja e disiplinës në punë është vjetërsuar.

Neni 32

1. Komisionit Disiplinor shpall vendimin mbi përgjegjësinë disiplinore të punëtorit. Përpilimi me shkrim i vendimit bëhet brenda 15 ditëve nga data e marrjes (seancës për këshillim dhe votim).
2. Vendimi përmban hyrjen, diapozitivin, arsyetimin dhe këshillën juridike.
3. Vendimin e nënshkruan kryetari i Komisionit dhe anëtarët e komisionit.

V. Zhvillimi i Procedurës Disiplinore në Komisionin e Ankesave

Neni 33

Kundër vendimit të Komisionit disiplinor punëtori mund të parashtrojë ankesë në afat prej 8 ditëve në komisionin për ankesa, kundër vendimit disiplinor. Po ashtu edhe DKA-ja (punëdhënësi) mund të bëjë ankesë.

Neni 34

Komisioni i Ankesave është obliguar për të vendosur sipas ankesës se punëtorit ne afatin brenda 15 ditëve ngas data pranimit te ankesës.

Neni 35

1. Komisioni për Ankesa mundet:
 - 1.2. ta aprovoj ankesën e punëtorit dhe ta liroj të njëjtin nga përgjegjësia;
 - 1.3. ta aprovoj ankesën e punëtorit dhe ta shqiptoj mase disiplinore më të butë;
 - 1.4. ta aprovoj ankesën e punëtorit dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe vendosje të serishme,
 - 1.5. ta refuzon ankesën dhe ta vërteton vendimin e shkallës së parë,
 - 1.6. ta hedh poshtë ankesën që është parashtruar jashtë afatit.

Neni 36

1. Vendimi sipas ankesës miratohet me votim.
2. Vendimi është i aprovuar nëse për të voton shumica e anëtarëve të Komisionit për Ankesa.

VI. Ekzekutimi i masave disiplinore

Neni 37

Masat disiplinore të shqiptuara ndaj punëtorit përgjegjëse ekzekutohet me marrjen e vendimit te formës se prerë.

Neni 38

1. Vërejtje me shkrim ekzekutohet me vendosjen në dosjen personale të punëtorit.
2. Dënim i ne të holla ekzekutohet ne atë mënyrë me zbritje të shumës (mëditjes) nga paga e përcaktuar me vendimin e drejtorit të shkollës.
3. Masa disiplinore ndërprerje së marrëdhënies së punës ekzekutohet në atë mënyrë që punëtori shkarkohet nga detyra e punës në datën kur vendimi merr formën e prerë, dhe njëkohësisht në të njëjtën datë ju ndërpritet marrëdhënia e punës.

VII. Pezullimi nga Marrëdhënia e Punës

Neni 39

1. Punëtori arsimor përkohësisht largohet nga vendi i punës nëse:
 - 1.1. është hasur në shkelje të rënda të detyrave të punës dhe mos largimi tij/saj vështirëson punën e punëtorëve tjerë, respektivisht procesin edukativ mësimore;
 - 1.2. kundër tij/saj është iniciuar procedure penale për shkak veprës penale në punë ose lidhur me punën;
 - 1.3. Punëtori është në vuajtje të paraburgimit;

Neni 40

Gjatë pezullimit nga puna punëtorit sipas Ligjit i takon kompensimi (pagesë) me lartësi prej 50% pagës.

Neni 41

Vendimin për suspendim/pezullim të punëtorit e merr drejtori i Drejtorisë së Arsimit.

Neni 42

1. Punëtorit i takon diferenca mes pagës gjatë suspendimit/pezullimit nga puna dhe pagës të cilën do ta kishte marr nëse nuk do të ishte suspenduar në rast:
 - 1.1. Nëse procedura penale kundër punëtorit është pezulluar me vendim plotfuqishëm, ose lirohet ngaakuza;
 - 1.2. Në qoftë se punëtorit nuk i shqiptohet masa disiplinore e cila mundë të shqiptohet për shkelje të rënda të disiplinës ë punës.

VIII. Përgjegjësia Materiale e Punëtorit

Neni 43

Punëtori përgjigjet për dëmin material të cilin me paramendim apo nga pakujdesia e rëndë i ka shkaktuar dëme materiale (pasurisë) së shkollës.

Neni 44

1. Secili punëtor është i obliguar të paraqet ekzistimin e dëmit në afat prej 24 orëve, të informoj drejtorin e shkollës.
2. Informata për dëmin material të shkaktuar paraqitet në formë të shkruar ose gojarisht.

Neni 45

1. Në bazë të paraqitjes apo informimit, drejtori i shkollës iniciacion procedurë për verifikimin e dëmit të shkaktuar dhe përgjegjësinë për këtë dëm.
2. Procedura për verifikimin e dëmit iniciohet me kërkesë.
3. Kërkesa për inicimin e procedurës për verifikimin e dëmit përmban shënimet mbi dëmin e shkaktuar, shënimet e punëtorit i cili ka shkaktuar dëmin, dhe provat me të cilat vërtetohet ekzistimi i dëmit dhe lartësia e tij.

Neni 46

1. Kërkesa për inicimin e procedurës për kompensimin e dëmit i dërgohet komisionit prej 3 anëtarëve, të cilin njëkohësisht me paraqitjen e kërkesës e emëron drejtori i Drejtorisë së Arsimit.
2. Komisioni mund të ftoj ekspertët të cilët do të ndihmojnë në punën e tij.

Neni 47

1. Komisioni verifikon ekzistimin, lartësinë e dëmit dhe përgjegjësinë e punëtorit, me dëgjimin e deklaratës së punëtori i cili ka shkaktuar dëmin, dëgjimin e dëshmitarëve, shikimin në vend të ngjarjes dhe ekspertizën në vendin e ngjarjes, si dhe nxjerrjen e provave tjera të nevojshme për të verifikuar objektivisht dëmin dhe përgjegjësinë e punëtorit.
2. Lartësia e dëmit vërtetohet në bazë të vlerave të regjistruara në kontabilitetit për mjetin e dëmtuar, nëse nuk është e mundur komisioni vlerëson dëmin me ndihmën e punëtorëve profesional të cilët janë të ftuar.

Neni 48

1. Komisioni bien vendim mbi përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, lartësinë e dëmit, dhe obligimin e punëtorit për kompensimin e dëmit.
2. Nëse punëtori kundërshton, nuk pajtohet me vërtetimin e dëmit, ose me përgjegjësinë për dëm, ose nuk pranon të kompenson dëmin, komisioni përpilon procesverbalin / njoftim, dhe të njëjtin ia dorëzon drejtorit te Arsimit.

Neni 49

Drejtoria e Arsimit është e obliguar që në afat prej 30 ditësh ti parashtron padi për kompensimin e dëmit pranë Gjykatës Kompetente.

IX. Dispozitat Përfundimtare

Neni 50

Nëse ndonjë çështje ka të bëjë me përcaktimin e përgjegjësisë së punëtorit, apo ndonjë çështje tjeter që nuk është përfshirë me ketë Rregullore do te zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi.

Neni 51

Kjo Rregullore hynë në fuqi 8 ditë pas publikimit të saj në tabelën e shpalljeve dhe në Ueb-faqen e Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira

